

FJALA E DEPUTETIT ALFRED RUSHAJ E ENJTE 28 TETOR 2021

Ne sapo depozituar një kërkesë në bazë të nenit 33 të Rregullores. Ka një ngjarje shumë të rëndë që është verifikuar në Krujë për shkak të ndotjes së ujit të pijshëm. Janë qindra qytetarë nga Kruja që janë detyruar të shkojnë në spital për të marrë ndihmën e shpejtë dhe, nga çfarë është verifikuar deri tani dhe është transmetuar nga burime të ndryshme, rezulton se kemi të bëjmë me një papërgjegjshmëri dhe shkelje të ligjit në furnizimin me ujë të pijshëm të qytetarëve të Krujës. Për këtë arsye ne sapo paraqitëm kërkesën të firmosur nga 10 deputetë, sipas nenit 31 të Rregullores, dhe kërkojmë të ndryshohet rendi i ditës, pra të votohet ndryshimi i rendit të ditës, dhe të vendoset si pikë e parë diskutimi për situatën emergjente të krijuar nga ndotja e ujit të pijshëm në Bashkinë e Krujës. Mendojmë se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e ka detyrim që të diskutojë për këtë ngjarje të rëndë që ka çuar në dëmtime masive, do të thosha, të shëndetit të qytetarëve në këtë bashki.

FJALA E DEPUTETIT ALFRED RUSHAJ E ENJTE 28 TETOR 2021- Pjesa e dytë

Zonja Kryetare, ne nuk kërkuam as hetime penale, nuk kërkuam asgjë tjetër veçse, në përputhje me nenin 31, pika 2, të Rregullores, kjo seancë të ndryshojë rendin e ditës dhe besoj të fillohet me diskutime për atë ngjarje që është shumë e rëndë. Të gjitha institucionet janë të mirëpritura të bëjnë punën e tyre, duke filluar nga policia, prokuroria dhe çfarë ka tjetër, por në këtë Kuvend kemi deputetë që përfaqësojnë qytetin e Krujës. Ata mendoj se janë të shqetësuar dhe duhet të diskutojnë për çfarë ka ndodhur, pse ka ndodhur dhe cilat janë masat që duhet të marrim që kjo gjë të mos përsëritet më. Kështu që kërkesa jonë është e mbështetur, siç e thashë edhe një herë, në nenin 31/2 të Rregullores, ku parashikohet që 10 deputetë mund të kërkojnë ndryshimin e rendit të ditës, në qoftë se ky Kuvend e miraton me tre të pestat. Unë ju ftoj që ta votojmë dhe deputetët që përfaqësojnë qytetarët e Krujës ta diskutojnë këtë ngjarje, që është jashtëzakonisht shqetësuese dhe shumë e rëndë.

FJALA E DEPUTETIT ALFRED RUSHAJ E ENJTE 28 TETOR 2021- Pjesa e tretë

Unë nuk kërkova, e përsëris, as të bëjmë hetime penale, nuk kërkova as të nxjerrim një ligj të veçantë, por kërkova të bëjmë diskutime. Për çështjen e provës dhe të faktit ka qindra të sëmure atje prej disa ditësh. Kështu që është diçka që mendoj se mjafton për të kërkuar vëmendjen tonë dhe për t'u lënë mundësi deputetëve të Krujës që të shprehin shqetësimet e tyre. Sidoqoftë, unë përsëri ju propozoj që ta hedhim në votë, ta ndryshojmë rendin e ditës dhe kjo seancë të fillojë me diskutime për këtë ngjarje që është shumë shqetësuese. Ju faleminderit!